



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE

SEKRETARI I ZYRËS - SECRETARY OFFICE - SEKRETAR KANCELARIJE

Nr. 42/2026

Data: 08.07.2026

Sekretari i Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës,
Në mbështetje të nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 47, 25 janar 2009), të Rregullores (MF) Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve (21 qershor 2017), Rregullores (P) Nr. 02/2022 për Organizimin dhe Funksionimin e Presidencës (30.12.2022), si dhe Udhëzimit Administrative (SZP) Nr. 04/2021 për Ndarjen e Subvencioneve në Presidencë nxjerr:

V E N D I M

**PËR SHPALLJEN E THIRRJES PUBLIKE PËR OFRIMIN E MBËSHTETJES
FINANCIARE PËR FINACIMIN E PROJEKTEVE/PROGRAMEVE PËR PERSONA
FIZIK DHE OJQ**

1. Autorizohet shpallja e thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare për financimin e Organizuarave jo Qeveritare (OJQ) dhe personave fizik.
2. Për implementimin e thirrjes publike nga pika 1 e këtij Vendimi do të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrative (SZP) Nr. 04/2021 për Ndarjen e Subvencioneve në Presidencë dhe të Rregullores (MF) Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
3. Mbështetja financiare nga thirrja publike për projekt/programet e personave fizik dhe OJQ-ve, do të bëhet nga buxheti i Zyrës së Presidentes, kategoria e subvencioneve dhe transfereve. Shuma e përgjithshme e ndarë për këtë thirrje publike është 150,000.00 (njëqind e pesëdhjetëmijë) euro.
4. Mjetet financiare nga pika 3 e këtij Vendimi do të ndahen në pajtim me thirrjen publike për financimin e projekt/programmeve të personave fizik dhe OJQ-ve.
5. Thirrja publike për ofrimin e mbështetjes financiare për financimin e projekteve/programmeve për personat fizik dhe OJQ si dhe dokumentacioni përkatës për aplikim publikohen në ueb-faqen e Presidentes së Republikës së Kosovës.

6. Thirrja publike do të implementohet nga Komisioni përkatës dhe trupat e tjerë që do t'i kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me Rregulloren (MF) Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe Udhëzimin Administrativ (SZP) Nr. 04/2021 për Ndarjen e Subvencioneve në Presidencë.

7. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.


Fehmi MEHMETI

Sekretar i Zyrës së Presidentes

Vendimi t'i dërgohet:

1. Zyrës së Sekretarit;
2. Shefes së Stafit të Presidentes;
3. Departamentit për Buxhet dhe Financa;
4. Kryetarit/ Anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve në Presidencë;
5. a/a.